

VENDIM
Nr.410, datë 11.7.2007

**PËR TRANSFERIMIN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË AMC SHA, QË KA MBETUR PAS
TRANSFERIMIT TË PAKETËS TEK INVESTITORËT STRATEGJIKË, TEK ISH-
PRONARËT E TRUALLIT DHE TE PUNONJËSIT E KËSAJ SHOQËRIE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” dhe të neneve 2, 3, pika 3, e 6, të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999 “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Albanian Mobile Communications” (AMC)”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paketa e aksioneve të AMC sh.a., që ka mbetur pas transferimit të paketës tek investitorët strategjikë, tek ish-pronarët e truallit dhe të punonjësit e kësaj shoqërie të transferohet, nëpërmjet ankandit, me asistencën e shoqërisë konsulente ndërkombëtare.

2. Shpenzimet për realizimin e procedurave të përzgjedhjes së konsulentit dhe për shërbimet e tij, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për transferimin e paketës të përballohen nga pjesa e dividendit të ortakut shtetëror në AMC sh.a.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha